VENDIM
Nr. 74, datë 6.7.2016

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "MBI PROCEDURAT E NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2, të nenit 43, shkronja "c" dhe të nenit 61, shkronja "a", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 16.1.2012, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli i nenit 7 ndryshon nga: "Ndërhyrja për rritjen e rezervës valutore", në: "*Ndërhyrja për ndryshimin e rezervës valutore*".

b) Në nenin 7, togfjalëshi: "programin monetar të miratuar", ndryshon në: "*kriteret e mjaftueshmërisë së rezervës valutore të miratuara*".

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Komiteti për Zbatimin dhe Këshillimin e Politikës Monetare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.8.2016.

KRYETARI
Gent Sejko